

**AKTI I THEMELIMIT
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“TRIO-2025”**

Unë, Ruben Taga, i datelindjes 30/12/1996, banues ne Lac, **shtetas shqiptar** I identifikuar me **ID. J61230056D** , që në vijim do te quhet **“Ortak”**;

Unë, Gerard Duni, i datelindjes 06/03/1996, banues ne **Durres**, **shtetas shqiptar** i identifikuar me **ID. J60306057H** , që në vijim do te quhet **“Ortak”**

Sot me date **06/03/2025**, vendosem te themelojme shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **“TRIO-2025”** ne perputhje me ligjin Nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”.

Kreu I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1.Objekti i shoqerise

1.1.Shoqeria ka kete objekt veprimtarie;

Shitje-Blerje Automjetesh , Makina me Qira , Import-Eksport .

1.2. Shoqeria kryen çdo lloj veprimtarie te dobishme per arritjen e objektivave te saj.

Neni 2.Emertimi dhe Selia juridike e Shoqerise

2.1. Ortaket vendosen qe shoqerine ta emertoje :

“TRIO-2025”

2.2. Selia e Shoqerise ndodhet ne : Durres, Zone Kadastrale 8512,sipas kontrates numer repertori 2303,nr.koleksioni 632 me date 29/04/2024 .

2.3. Shoqeria mund te krijojë qendra sekondare , filiale, zyra perfaqesimi e agjensi ne qytete te tjera te Shqiperise ose jashte vendit.

Neni.3. Regjimi Juridik

3.1. Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Stautit, dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi

3.2. Me vendim te tyre Ortaket mund te ndryshoje regjimin juridik te Shoqerise, nese ne te ardhmen krijohen premisa me te favorshme per funksionimin e saj sipas legjislacionit shqiptar.

Ne kete rast Ortaket do te pershtasin Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise, si dhe do te beje regjistrimin e saj ne Regjistrin Tregtar ne organet kompetente shqiptare.

3.3. Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe ne perputhje me ligjin

3.4. Shoqeria do te kete vulen e saj

Kreu II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut

4.1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata ne territorin e Shqiperise dhe jashte saj .

4.2. Shoqeria gezon te drejten te krijojë pasuri materiale dhe intelektuale.

4.3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortakë ne shoqeri ose ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi ose jashte saj, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar.

4.4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj shoqeror te derdhur dhe me te mirat e pasurise se saj.

4.5. Ortaku ka te drejte te marre te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te Shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike, etj

4.6. Ortaku ka te drejte te beje propozime, si dhe emeroge e shkarkoje, administratorin ose administratoret, punonjesit, ekspertin kontabel, apo likuidatoret

Neni 5

Kohezgjatja

5.1. Kohezgjatja e Shoqerise eshte me afat te papercaktuar.

Kreu III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

6.1. Kapitali themeltar eshte **8.000.000** (tete milion) leke I perbere nga 2(dy) kuota.

6.2. Z. Ruben Taga ne cilesine e ortakut do te posedoje 1 kuote ,50% e kapitalit themeltar me vlere 4.000.000 leke nga te cilat ne natyre automjete 4.000.000 leke vleresuar me marreveshje mes ortakëve .

6.3. Z. Gerard Duni ne cilesine e ortakut do te posedoje 1 kuote ,50% e kapitalit themeltar me vlere 4.000.000 leke.

Kreu IV
ORGANET E SHOQERISE

Neni 7

7.1. Vendimet ne Shoqeri merren nga Ortaket ne Asamblene e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise dhe ekspeti kontabel i autorizuar caktohen nga Ortaket e shoqerise.

Kreu V
ADMINISTRIMI

Neni 8

8.1. Administrimi i shoqerise do te behet nga **Administratori** i saj **Z. Ruben Taga**, titullar I kartes se identitetit me numer personal **J61230056D**.

8.2. Kohezgjatja ne detyre e administratorit te shoqerise do te jete 5 (pese) vjet me te drejte riperteritje ne perfundim te mandatit.

Kreu VI
DISPOZITA TE TJERA

Neni 9

9.1. Fitimi I realizuar nga Shoqeria, mbas shlyerjes se detyrimeve ligjore do t'i mbetet Ortakeve te shoqerise ne raportet e zoterimit te kuotave te kapitalit.

9.2. Ky akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te shoqerise.

ORTAKET E SHOQERISE "TRIO-2025" SHPK

Ruben Taga



Gerard Duni

